

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
BORDI DREJTUES

Nr. 1749 Prot.,

Tiranë, më 08 .11 .2024

VENDIM

NR. 1 DATË 08 .11 .2024

PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 17.06.2019 TË BORDIT
DREJTUES "PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE DHE TË ORGANIKËS
TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)"

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 4 dhe të nenit 11, të Ligjit Nr. 10303, datë 15.07.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve",

BORDI DREJTUES

VENDOSI:

Në vendimin nr. 3, datë 17.06.2019, të Bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 1, ndryshon si më poshtë:

"Klasat e pagave janë sipas lidhjes nr. 1/1 dhe grupet e diplomave për nëpunësit e AIDA mbeten të pandryshuara sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij".

2. Fjalja e parë e pikës 3, ndryshon si më poshtë:

"Për natyrë të veçantë pune jepet një shtesë mbi pagën mujore të klasës përkatëse, si vijon..."

3. Pika 5, ndryshon si vijon:

"Vlerat për secilin element të klasave të pagave IV-3, IV-2, IV-1, III-1, II-2, II-1 dhe I-4, do të jenë sipas vlerave të përcaktuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civil".

4. Pika 8, ndryshon si më poshtë:

"Struktura e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të jetë sipas lidhjes nr. 4/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij".

5. Pika 9, ndryshon si më poshtë:

“Organika e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të jetë sipas lidhjes nr. 5/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

6. Pika 10, ndryshon si më poshtë:

Numri i punonjësve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të jetë gjithësej 51 punonjës.

7. Pika 12, ndryshon si më poshtë:

“Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv për t’i dërguar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për trajtimin me prioritet dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme të akteve nënligjore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave, për ti përfshirë në programin e saj buxhetor”.

8. Kudo, nëpër vendim, fjalët “*kategori e pagës*” zëvendësohet me fjalët “*klasa e pagës*”.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare pas parashikimit në ligjin për buxhetin e shtetit.

KRYETARI I BORDIT DREJTUES

EDI RAMA



MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGIJË

BELINDA BALLUKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
BORDI DREJTUES

Lidhja nr. 1/1


Klasat e pagave për nëpunësit e AIDA-s

POZICIONI	KATEGORIA		KLASA E PAGËS	Grupi i Diplomës
Titullar i AIDA-s.	E lartë drejtuese	I	I-4	1
Drejtor i drejtorive të përmbajtjes	E mesme drejtuese	II	II-1	1
Drejtor i Drejtorisë Shërbimeve Mbështetëse			II-2	1
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	E ulët drejtuese	III	III-1	1
Përgjegjës sektori			III-2	1
Specialist në sektorët e përmbajtjes	Ekzekutive	IV	IV-1	1 ose 2 ose 3
Specialist			IV-2	1 ose 2 ose 3
			IV-3	1 ose 2 ose 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
BORDI DREJTUES

Lidhja nr. 4/1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
BORDI DREJTUES

Lidhja nr. 5/1

ORGANIKA E AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE			
	POZICIONI	KLASA E PAGËS	NUMRI
1	DREJTOR EKZEKUTIV	I-4	1
2	DREJTORIA E INVESTIMEVE STRATEGJIKE		10
	DREJTOR	II-1	1
2.1	SEKTORI I MONITORIMIT		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-1	1
	SPECIALIST	IV-1	3
2.2	SEKTORI ONE STOP SHOP		5
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-1	1
	SPECIALIST	IV-1	4
3	DREJTORIA E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE, PARTENRITETIT DHE KËRKIMIT		10
	DREJTOR	II-1	1
3.1	SEKTORI LEAD AND AFTER CARE		5
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-1	1
	SPECIALIST	IV-1	4
3.2	SEKTORI KËRKIM DHE ZHVILLIM		4
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-1	1
	SPECIALIST	IV-1	3
4	DREJTORIA MARKETING		6
	DREJTOR	II-1	1
	SPECIALIST	IV-1	5
5	DREJTORIA E PROJEKTEVE, NVM DHE EKSPORTE		11
	DREJTOR	II-1	1
5.1	SEKTORI I ZHVILLIMIT TË PROJEKTEVE		5
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-1	1
	SPECIALIST	IV-1	4
5.2	SEKTORI I NVM DHE EKSPORTEVE		5
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-1	1
	SPECIALIST	IV-1	4
6	DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		13
	DREJTOR	II-2	1
6.1	SEKTORI I FINANCËS		3

	SPECIALIST	IV-2	3
6.2.	SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHETËSE		9
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-2	1
	SPECIALIST BURIME NJERËZORE	IV-2	1
	SPECIALIST JURIST	IV-2	1
	SPECIALIST ARKIV/PROTOKOLL	IV-3	1
	PUNONJËS PASTRIMI	Klasa I	1
	SHOFER	Klasa III	2
	NËPUNËS INFORMACIONI	Klasa II	1
	MAGAZINIER	Klasa V	1
	PUNONJËS GJITHSEJ		51